



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Municipal Istog  
Municipal Istog

## Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.321/21  
Datë: 07.07.2021

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik nën 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet në Republikën e Kosovës, UA-MPMS, Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si dhe UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, shpall këtë:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës/e, viti shkollor 2021/2022

#### SHFMU "Bajram Curri" në Istog

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, vend i lirë i punës normë e plotë.
2. Dy mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, vende të lira të punës nga data 03.03.2022
3. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, vendi i lirë i punës paralelja e ndarë në Cerrcë
4. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë paralelja e ndarë në Dubravë.

#### SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me normë të plotë në dy shkolla, "Hysni Zajmi" Vrellë dhe "Zymer Zeka" në Kaliqan.
2. Një mësimdhënës/e për Fizikë, normë jo e plotë në dy shkolla, "Hysni Zajmi" Vrellë dhe "Zymer Zeka" në Kaliqan, vendi i lirë i punës prej 15.10.2021.

#### SHFMU "Martin Camaj" në Gurrakoc

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me normë të plotë, në dy shkolla në SHFMU "Martin Camaj" në Gurrakoc dhe "Bajram Curri" në Istog.
2. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë, prej datës 21.09.2021 paralelja e ndarë Llukac i Thatë.
3. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë paralelja e ndarë Llukac i Thatë.
4. Një mësimdhënës/e për TIK- zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë prej datës 01.10.2021.

#### SHFMU "Trepça" në Banjë

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me normë të plotë në tri shkolla , "Trepça" në Banjë , "Fan.S.Noli" në Llukac i Begut si dhe "Ismail Qemali" Saradran (vende të lira).
2. Një mësimdhënës/e për Kimi (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Banjë dhe Dobrushë.
3. Një mësimdhënës/e për Fizikë, normë e plotë vendi i lirë i punës nga data 06.09.2021
4. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, zëvendësim derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë prej datës 01.10.2021.
5. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### SHFMU "Ismail Qemali" në Staradran.

1. Një mësimdhënës/e për Edukatë Figurative, në dy shkolla normë jo e plotë vendi i lirë i punës.

#### SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane, me normë jo të plotë për tri shkolla "Ndre Mjeda" Rakosh , "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë dhe "Mehmet Aki" në Shushicë.
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, vend i lirë i punës nga data 16.04.2022 normë jo e plotë.
3. Një mësimdhënës/e për Fizikë, normë jo e plotë në dy shkolla vend i lirë i punës prej 01.09.2021.
4. Një mësimdhënës/e për Matematikë, vendi i lirë i punës nga data 05.02.2022 normë jo e plotë.
5. Një mësimdhënës/e për Matematikë, normë jo e plotë në dy shkolla, "Ndre Mjeda" Rakosh dhe "Avni Rrustemi" në Zallq.
6. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë në paralelen e ndarë në Veriq.
7. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, deri në përfundim të mandatit të drejtorit të shkollës (pozitë me afat të caktuar).

#### SHFMU "Fan.S.Noli" në Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5 zëvendësim, derisa punëtorja të kthehen nga pushimi i lehonisë prej datës 01.09.2021.
2. Një mësimdhënës/e për gjuhë gjermane (për nxënësit e komunitetit boshnjak) në dy shkolla Dobrushë dhe Banjë normë jo të plotë.
3. Një mësimdhënës për Biologji (në gjuhën boshnjake), me normë jo të plotë në Dobrushë dhe Banjë.

#### SHFMU "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" në Uçë

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.
2. Një mësimdhënës/e për Fizikë - normë jo e plotë
3. Një punëtor/e ndihmës/e (pastrues/e) vend i lirë

#### SHFMU "Mehmet Akif" në Shushicë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### SHFMU "Zymer Zeka" në Kaliqan

- 1 Një edukatore për parafillorë, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog

1. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### SHFMU "Mit'hat Frashëri" në Gurrakoc

1. Tre mësimdhënës/e për drejtimin e infermierisë ( mjek specialist ose mjek i përgjithshëm), me normë të plotë.
2. Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, vend i lirë i punës nga data 04.04.2022 norme e plotë.

#### IP "Shpresa Jonë" Banjë

1. Një asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (për fëmijët e komunitetit boshnjak).
- Gjithashtu, Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, duke u bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit shpallë edhe 4 (katër) pozita pune për Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Kandidatëve për këto pozita , sipas nenit 8 pika 6 e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, u kërkohet kualifikimi si me poshtë:
  - Nivelit i 5-të (post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.
  - Për vendin e punës punëtor/e ndihmës/e është obligative që kandidatët ta kenë të përfunduar shkollën e Mesme të Lartë.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes, jo më e vjetër se 6 muaj,
- Kopja e diplomës e vërtetuar të **Noteri**, ose certifikata në vend të diplomës jo me e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

**Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, MASHTI, Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 06.08.2021 deri 20.08.2021.**

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhes dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorëzohet pas afatit nuk do të shqyrtohet. Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi, kurse intervistës do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët - kandidatet, të cilët- të cilat arrijnë të kenë me shumë se 50 për qind të kalueshmërisë së testit me shkrim.



Preritori i DKA-së  
Hajrush Shoshi